



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-26-4102-1-3-6/C1160
14 Nr. 531/26
Dt. 23.07.2026

KONTRATË FURNIZIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Ilmi Azemi – Drejtor i ZPP-së** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**) dhe
2. **SIA TECH L.L.C., Prishtinë, Kosove**, emri i tregtar/, emri i biznesit **SIA TECH L.L.C.**, me seli në Prishtinë, me ARBK : **811983388**, të cilën e përfaqëson **z.Vigan Berisha**, në tekstin e mëtejshëm: **FURNIZUESI**,

, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë: **Furnizimi me rekuizita dhe paisje sportive., me numër identifikues:**

Nr. i prokurimit	VU644	2	6	41	0	2	1	3	6
Nr. i brendshëm	VU644	2	6	0	2	6	1	3	6

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Furnizimi me rekuizita dhe paisje sportive për objekte shkollore, ashtu sikurse është specifikuar ne Aneksin 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme pjesë e Dosjes së Tenderit.**
- 1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit dhe përfundon brenda afatit: **jo më gjatë se 15 ditë pas datës së nënshkrimit të kontratës.**
- 1.3 Vendi i **dërgimit do të jetë : Sipas planit të shpërndarjes në depot e njësive kërkuese. (DKA).**
- 1.4 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 **Çmimi total i kontratës do të jetë: 1,159.00 €; [njëmijëenjëqindpesëdhjetëenëntë/00] Euro.**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës **pasi që Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i pranimit të mallit i Autoritetit Kontraktues të konfirmoi me shkrim pranim-Furnizimi me rekuizita dhe paisje sportive. respektivisht pas dorëzimit të Raportit me shkrim se Furnizimi me rekuizita dhe paisje sportive është dorëzuar – pranuar nga A.K. , si në aspektin teknik dhe në aspektin cilësor. Raporti me shkrim i hartuar dhe nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i pranimit të mallit do të dorëzohet, një kopje Kontraktuesit/Furnizuesit dhe një kopje Drejtorisë për Prokurim me qëllim të procedimit me pagesat për furnizimin dhe / ose shërbimin e përfunduar.**

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i **furnizimit dhe / ose shërbimit** është përgjegjësi e Furnizuesit ndërsa pajisa e dorëzuar duhet, në të gjitha aspektet, të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **furnizimit dhe / ose shërbimit** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 8 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 9 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 12 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet **në Gjykatën Komerciale në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.**

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;


- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (d) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

E hartuar në gjuhën **Shqipe** në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik:
SIA TECH L.L.C.

Për Autoritetin Kontraktues – **Komuna e Vushtrrisë**

Emri:	Vigan Berisha	Emri:	Ilmi Azemi
Pozita:	Drejtor ekzekutiv	Pozita:	Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	23.07.2026	Data:	23.07.2026
Vula:		Vula:	



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
14 Nr. 542/26
Dt. 27.07.2026

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 43 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik / Nr.A01, në bashkëpunim dhe propozim dhe të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese DKA-së dhe ZPP-së, më dt. **27.07.2026** merë:

V E N D I M

Emërohen Menaxherë të kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës për përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka: **Furnizimi me rekuizita dhe paisje sportive, me numër të prokurimit: VU644-4102-136 dhe numër të brendshëm të prokurimit VU644-26-026-136**, si vijon :

z.Kamber Beqiri, emërohet menaxher i kontratës.

Z.Naile Kovaçi emërohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherëve të Kontratës,

1. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëheqësit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës.

Përgjegjësitë dhe funksionet e Menaxherit të Projektit / Kontratës, janë me sa vijon, të :

- Menaxhoi obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Kontratë;
- Sigurojë që Op. Ek. i përmbushë të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Op. Ek. e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë se ka kontroll adekuate të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së Kontratës;
- Sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;
- Nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- Jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit;
- Dorëzoj raporte mbi progresin ose kompletimin e një kontratë, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga Zyrtari Kryesor administrativ;
- Në pajtim me nenin 61.7 të rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si

menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës i A. K. duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloi me fazat e menaxhimit të projektit / Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i projektit/ kontratës brenda afatit optimal/ të arsyeshëm kohorë, jo më gjatë se dy ditë pune, duhet të krijoj një Plan për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin " Fillimi / mobilizimi i kontratës". Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohej nga Sistemi i prokurimit elektronik në bashkëpunim me Menaxherit të kontratës të A.K. dhe O.E. - Kontraktuesit, duke e nënshkruar të dyja palët. Menaxheri i Projektit do ta përcjell një kopje të Planit për menaxhimin e kontratës Departamentit të Prokurimit. Pasi Zyrtari përgjegjës i Prokurimit pranon Planin për menaxhim të kontratës, Menaxheri i Projektit do të lëshoj Op. Ek. kontraktuesit letrën për fillimin e punëve, kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të kontratës, përgjegjësi të përcaktuara si në Kushtet Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

- Në baza mujore dhe në bazë të gjendjes së konstatuar Menaxheri i Kontratës do të hartoi Raport mujor në të cilin do të përshkruhet gjendja faktike nëse çdo pajisje ka funksionuar në rregull dhe nëse shërbimet janë ekzekutuar në përputhje me

kushtet e Kontratës dhe Porosinë. Nëse konstaton të meta dhe/ ose parregullsi në ekzekutimin e shërbimeve do të kërkoj mënjanimin e tyre duke i

caktuar Kryesit të Shërbimeve - Kontraktuesit afatin për mënjanimin e parregullsive. Nëse Menaxheri konstaton se nuk ka të meta dhe / ose parregullsi në ekzekutimin e shërbimeve dhe përmbushjen e obligimeve kontraktuese, atëherë do të do të përpiloj – lëshoj një Raport të veçantë mbi përfundimin e shërbimeve të Porositura në baza mujore, të cilin një kopje, të nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës, në afatin më të shkurtë kohorë do t'ia dërgoj Kryesit të Shërbimeve, ndërsa një kopje Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik, me qëllim të procedimit të mëtejshëm

- kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të kontratës, përgjegjësi të përcaktuara si në Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

Përgjegjës dhe funksionet e Mbikëqyrës të Menaxherit të Projektit/ Kontratës, janë me sa vijon :

- mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e implementimit të kontratës;
- administrimi i plotë i kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventual të kontratës, dhe
- rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit- vlerësim të propozuar nga menaxheri i kontratës nën mbikëqyrjen e tij.

1. Vendimi hyn në fuqi dhe zbatohet ditën e marrjes ndërsa, për bazë do të ketë zbatimin e përpiktë të kontratës mes Autoritetit Kontraktues – Komunës së Vushtrrisë Operatorit **SIA TECH L.L.C., Prishtinë, Kosove, emri i tregtar/, emri biznesit SIA TECH L.L.C.,** me seli në Prishtinë, me ARBK : **811983388**, të cilën e përfaqëson **z.Vigan Berisha**, në tekstin e mëtejshëm: **FURNIZUESI**,

Kopje: Menaxheri i Kontratës;
Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës;
Drejtorisë së Prokurimit;
Drejtoria të Njësive Kërkuese

Ferit Idrizi



Kryetar i Komunës



Sigurimi për Garanci Guarantee Insurance

Seria | 10001368206

Për

KOMUNA E VUSHTRRIË

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

Titulli
Title

Furnizimi me rekuizita dhe paisje sportive

Emri i Ofertuesit
Name of the Bidder

SIA TECH L.L.C.

Prej
From

24.07.2026

Adresa
Address

Malush Kosova p.n., .

Deri
To

07.09.2026

Telefon
Telephone

+38349588805

Shuma e sigurimit
Insured sum

115.90 €

Numri i personal / biznesit
Personal / business number

811983388

Primi
Premium

20.00 €

Data e lëshimit
Date of issue

23.07.2026

TVSH
VAT

3.60 €

Numri i prokurimit
Procurement number

644-26-4102-1-3-6

Totali për pagesë
Total for payment

23.60 €

Lloji i kontratës
Contract type

Garanci Kontrate

AUTORITETI KONTRAKTUES

Numri personal / biznesit
Personal / business number

0000

Vendi
City

Prishtine

Adresa
Address

Prishtine

Telefon
Telephone

044

Policë e sigurimit

DEKLAROJ se pohimet e bëra në këtë kërkesë për sigurim janë të plota dhe të vërteta dhe nëqofse ka fshehje apo shtrembërim të fakteve, unë heqë dorë nga dëmshpërblimi në rast dëmi. Policëmbajtësi deklaron se prejardhja e fondeve është në përputhje me Ligjin nr.05/L-096 si dhe Nenin 9 të Rregullores për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të Bankës Qendrore të Kosovës

Insurance Policy

I DECLARE that the allegations made in this insurance claim are complete and true and if there is concealment or distortion of the facts, I waive compensation in case of damage. The police officer declares that the origin of the funds is in accordance with Law no. 05/L-096 as well as Article 9 of the Regulation on the prevention of money laundering and terrorist financing of the Central Bank of Kosovo

Agjenti

Selim Shabani



Kompania e Sigurimeve PRISIG SH.A / Numri unik identifikues: 810842832 / Tel: +383 (0) 38 221 000

Email: info@prisia-ks.com / www.prisia-ks.com / Adresa: Rr. Eduard Lir 173 Laciia Arbëria, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Lloji i Garancisë: Garanci Kontrate

Seria |

10001368206

Për

KOMUNA E VUSHTRRIË

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

DUKE PASUR PARASYSH QË

SIA TECH L.L.C.

(emri i operatorit ekonomik, në tekstin e mëposhtëm "Operatori Ekonomik")

ka marrë përsipër të lëshoj një sigurim të realizimit lidhur me kontratën me titull

Furnizimi me rekuizita dhe paisje sportive

të dhënë me numrin e Prokurimit

644-26-4102-1-3-6

(Nr. i referencës së prokurimit)

për Operatorin ekonomik nga Autoriteti Kontraktues;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË Operatori Ekonomik dëshiron të lëshojë një garanci për shumën e sigurimit e specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë garanci:

PËR KËTO ARSYE vërtetojmë që ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej

115.90 €

Një Qind e Pesëmbëdhjetë Euro e Nëntëdhjetë Cent

(shuma e garancisë në numra dhe në fjalë)

dhe ne marrim përsipër të ju pagujmë, me kërkesën tuaj të parë me shkrim që deklarohen që Operatori Ekonomik ka bërë gabim sepse:

- Autoriteti kontraktues është konfrontuar me humbje substanciale që janë rezultat i dështimit të Operatorit Ekonomik për të kryer obligimet e veta sipas kontratës; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo shkakton dëm të konsiderueshëm të Autoriteti kontraktues dhe/ose kërkon nga Autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të konsiderueshme për realizimin e kësaj kontrate; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo ka lënë pa pagesë shumë punëtorë, nënkontraktues, dhe/ose furnizues material; ose
- Ofertë jonormalisht e ulët e dorëzuar nga Operatori Ekonomik zbulon që kjo ofertë nuk mund të realizohet dhe pa asnjë ankesë ose argument, të gjitha shumatat brenda limiteve të

115.90 €

(shuma e garancisë)

siç është thënë më lart, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepen arsyet ose bazat për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës

24.07.2026

deri më

07.09.2026

Lëshuar në

Prishtinë

datë

23.07.2026

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit

PRISHTINË



Klienti: SIA TECH L.L.C.
Adresa: Malush Kosova p.n.,
Vendi: Prishtinë
NUI / ID: 811983388
Telefoni: +38349588805

Fatura nr. | Invoice no.

23072026-10001368206



Data e faturës: 23.07.2026

Nr.	Përshkrimi	Nr. i të siguruarve	Çmimi pa TVSH	TVSH	Totali me TVSH
1	Sigurimi për Guarantee nga PRISIG Për "811983388"	1	20.00 €	3.60 €	23.60 €

Totali	20.00 €	3.60 €	23.60 €
---------------	---------	--------	---------

Te dhënat Bankare:

Pagesa të bëhet në llogaritë bankare si vijon:

PriBank SH.A: 2410 1301 0000 0809

ProCredit Bank: 1189 0056 0100 0105

Raiffeisen Bank: 1501 0900 0326 0728

NLB Prishtina: 1701 0015 0000 0551

Banka Kombetare Tregtare: 1902 8620 1203 1148

Banka Ekonomike: 1401 0000 0041 3690

Banka për Biznes: 1300 0010 0219 2836

IS BANK: 2148 0307 1350 0211

TEB BANK: 2034 0001 0974 9152

Në rast mos pagese brenda afatit 7 ditor nga dita e lëshimit të faturës, kompania ka të drejtë që në bazë të kësaj fature të iniciojë procedurë përbarim dhe të kërkojë përmbushjen e saj përmes përbarimit.

Agjenti/Siguruesi

Selim Shabani



I siguruesi

SIA TECH L.L.C.

AUTORIZIM PËR NËNSHKRIMIN E KONTRATËS

Republika e Kosovës

Për: [KOMUNA E VUSHTRISË]

Datë: 24.07.2026

AUTORIZIM

Më anë të këtij autorizimi kompania **SIA TECH L.L.C** më pronar Fatimë Rexhepi Bërisha autorizon për nënshkrimin e kontratës pranë AK-së të autorizuarin e më poshtëm :

AUTORIZOJ

Z. [GAZMEND FEKA], më pozitë [MENAXHER – I AUTORIZUAR], që në mënyrë dhënë për llogari të [SIA TECH L.L.C], të nënshkruajë kontratën:

Titulli i aktivitetit/projektit: [Furnizimi me rekuizita dhe paisje sportive]

- Numri i prokurimit: [644-26-4102-1-3-6]

Përsoni i autorizuar ka të drejtë të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me nënshkrimin e kontratës së lartcukur, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të institucionit.

Ky autorizim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe vlen vetëm për qëllimin e cukur në këtë dokumnt.

AUTORIZUESI :

I AUTORIZUARI :

SIA TECH L.L.C

Z.GAZMEND FEKA

24.07.2026



Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G. Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normen e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%,8%-apo-48%, Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy numra pas presëjes dhjetore

Furnizim me rekuizita dhe paisje sportive

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSH)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
I Furnizim me rekuizita dhe paisje sportive									
1	Top Futboll - Madhësia nr.5, material PU sintetik, qepje termike ose me makinë, rezistent ndaj lagështisë, peshë 410–450g	copë	5	€ 10.17	18.00	12.00	50.85	9.15	60.00
2	Top Hendbolli- Madhësi standarde për shkolla të mesme, material sintetik anti-slip, me bladder butyl	copë	8	€ 6.36	18.00	7.50	50.85	9.15	60.00
3	Top Volejbolli -i Madhësia nr.5, material PU soft touch, 18 panele, peshë 260–280g	copë	5	€ 7.63	18.00	9.00	38.14	6.86	45.00
4	Top Basketbolli - Madhësia nr.7, material composite leather/gomë profesionale, anti-slip	copë	4	€ 11.02	18.00	13.00	44.07	7.93	52.00
5	Top ping pongu ABS plastik-, 3 yje, diametër standard 40 mm	set	5	€ 0.85	18.00	1.00	4.24	0.76	5.00
6	Pip FOX40 Bibil - profesional pa sferë, material plastik rezistent	copë	4	€ 0.85	18.00	1.00	3.39	0.61	4.00
7	Kronometër Digjital, matje deri 24 orë, rezistent ndaj goditjeve	copë	4	€ 2.12	18.00	2.50	8.47	1.53	10.00
8	Peshore digjitale - Matje peshe dhe gjatësie, ekran LCD, kapacitet min. 200kg	copë	1	€ 127.12	18.00	150.00	127.12	22.88	150.00
9	Metër Metër sportiv 50m, fibër rezistente me mbështjellës plastik	copë	2	€ 8.47	18.00	10.00	16.95	3.05	20.00
10	Rrjetë Volejbolli Najlon profesional 9.5m x 1m, trashësi min. 2mm	copë	3	€ 12.71	18.00	15.00	38.14	6.86	45.00
11	Rrjetë Portash Material PE najlon, rezistente UV, dimension standard	copë	2	€ 21.19	18.00	25.00	42.37	7.63	50.00
12	Tabelë koshi Plexiglass transparent ose fibër profesionale, dimension standard		2	€ 84.75	18.00	100.00	169.49	30.51	200.00
13	Hark koshi Hark metalik me susta, diametër standard 45 cm copë	copë	2	€ 16.95	18.00	20.00	33.90	6.10	40.00
14	Rrjeta për hark koshi Najlon/polyester rezistent ndaj motit	copë	6	€ 2.12	18.00	2.50	12.71	2.29	15.00
15	Tavolinë Ping Pongu MDF profesional 18–25mm, me rrota dhe rrjetë	copë	1	€ 186.44	18.00	220.00	186.44	33.56	220.00
16	Reketa ping pongu Dru shumë-shtresor me gomë profesionale	copë	6	€ 4.24	18.00	5.00	25.42	4.58	30.00
17	Rrjetë për tavolinë ping pongu Rrjetë najloni me mbajtëse metalike	copë	3	€ 4.24	18.00	5.00	12.71	2.29	15.00

18	Garniturë shahu Set standard edukativ me tabelë dhe figura plastike	set	3	€	12.71	18.00	15.00	38.14	6.86	45.00
19	Piramida Shenjues plastik për ushtrime sportive, set min. 20 copë	set	2	€	8.47	18.00	10.00	16.95	3.05	20.00
20	Pompë dore me gjilpërë për topa sportive	copë	1	€	5.93	18.00	7.00	5.93	1.07	7.00
21	Dresa sportive për nxënës -Komplet sportiv për nxënës të moshës 16–18 vjeç, për djem, njëngjyrëshe, material 100% poliestër, rezistente ndaj djersës dhe larjes, bluzë me mëngë të shkurtra + shorc, madhësi të ndryshme (M, L, XL), ngjyrë e njëjtë për kompletin, set prej 10 copë	set	4	€	6.36	18.00	7.50	25.42	4.58	30.00
22	Kompleti i ndihmës së parë-Set standard emergjent sportiv	set	2	€	8.47	18.00	10.00	16.95	3.05	20.00
23	Mates tensiononi /Digjital për kontroll bazik shëndetësor	copë	2	€	6.78	18.00	8.00	13.56	2.44	16.00
TOTALI I PËRGJITHSHEM ME TVSH:									176.80	1,159.00

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	SIA TECH L.L.C
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	FATIME REXHEPI BERISHA
NËNSHKRIMI:	
DATA:	11.06.2026
VULA:	